



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.36, datë 20.11.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.11.2025 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit, "Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.02.2023, "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a", i ndryshuar.

Konstatoi:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a me shkresën nr. 6318 prot. datë 07.11.2025 me lëndë: "Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknik", plotësimet e bëra me postë elektronike datë 17.11.2025, të cilat më pas i kanë dërguar dhe me postë zyrtare me nr. 604/1 prot. të ERRU-së, datë 20.11.2025, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor dhe drejtuesve teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar;

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës për rinovim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.
3. KKRR ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a me vendimin nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës z. Olsen Kavalli zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili “Profesional -Energjistikë, viti 2011, në Universitetin Politeknik i Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, si dhe diplomë Master Shkencor në “Politika dhe Administrim”, Profili “Administrim Publik”, viti 2019, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
5. Drejtues teknik i shoqërisë z. Tonin Doda me titull Inxhinier Markshajder është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti Gjeologji - Miniera, Dega Miniera (Specialitet i Markshajderit) në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
6. Drejtues teknik i dytë i shoqërisë z. Migen Duka, zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike, viti 2020 dhe diplomë Master i Shkencave në Hidroteknik, viti 2022, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
7. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesve teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 a), 2 b) dhe 2c) i vendimit të KKRR nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a”, i ndryshuar, ndryshojnë si më poshtë:

- a) Drejtues Ligjor z. Olsen Kavalli
- b) Drejtues Teknik z. Tonin Doda
- c) Drejtues Teknik z. Migen Duka

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

GERTA LUBONJA